



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 206 Prot.

Tiranë, më 26, 01, 2023

**Lënda:** Raportim mbi detyrat e realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, për periudhën janar-dhjetor 2022.

Znj. Mimoza DHËMBI

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM ( E komanduar)

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

TIRANË

Në mbështetje të Rregullores së Brëndshme nr. 104/1, datë 07.02.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e DPM-së", Ju raportojmë mbi detyrat e realizuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën janar - dhjetor 2022, sipas drejtorive përkatëse:

**I. DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", Rregullores së Brëndshme të DPM-së Nr. 104/1, datë 07.02.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e DPM-së", Memo me Nr.1825 prot, datë 14.12.2021 "Miratimi i planit të punës për Drejtorinë e Metrologjisë Ligjore për vitin 2022", si dhe urdhërit nr.295, datë 10.12.2021 "Për miratimin e Planit të Sektorëve të Shërbimit të DML, për treguesit ligjor, teknik dhe ekonomik, për vitin 2022", si dhe urdhërit nr.210, datë 06.06.2022 "Për miratimin e ndryshimit të planit të sektorëve të shërbimit të DML-së, për treguesit ligjor, teknik dhe ekonomik, në vazhdimësinë e vitit 2022", po paraqesim analizën e punës së DML-së për vitin 2022, duke parashtruar rezultatet e arritura dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë këtij viti.

**Mbrojtja e konsumatorit nga matjet e pasakta**

- Numri i instrumenteve të planifikuara për t'u verifikuar ishte 38 300 dhe janë verifikuar 36 668, me realizim 95.7 %;
- Subjektet ishin planifikuara 23 230 dhe janë realizuar 20 453, me realizim 88 %;
- Treguesi i të ardhurave ishte planifikuar në masën e 48 500 000, por janë realizuar 54 988 699 të ardhura (pa TVSH), me realizim 113.4%.

Numri i instrumenteve të verifikuar gjatë vitit 2022 është 36 668, nga të cilët: 14 707 janë masa volumërore ose 40.1% e instrumenteve të verifikuara, 4 139 gramare, ose 11.3%, 10 191 peshore, ose 27.8%, 238 peshore automoblistike, ose 0.6%, 4 013 dozator, ose 10.9%, 2 187 taksimetra, ose 6%, 424 rezervuare, ose 1.2%, 392 kontalitra, ose 1.1% dhe 377 metra, ose 1%.

Gjatë vitit 2022 janë përgatitur 52 (pesëdhjetë e dy) kthim përgjigje, nga të cilat 20 (njëzetë) janë ndaj subjekteve juridik e fizik, 4 (katër) ndaj personave fizik, 26 (njëzetë e gjashtë) ndaj institucioneve shtetërore dhe 2 (dy) kthim përgjigje janë për Media-n.

#### **Kryerja e vizitave monitoruese**

##### **- Dhënia e autorizimeve**

Gjatë vitit 2022 janë nxjerr 6 (gjashtë) vendime administrative, nga të cilët janë: 2 (dy) riautorizime, 3 (tre) autorizim për herë të parë dhe 1 (një) ndryshim autorizimi. Nga 6 (gjashtë) vendimet administrative (autorizime) të dhëna, 2 janë për verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matësa uji, 3 (tre) për riparim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, shpërndarës karburanti dhe 1 (një) ndryshim autorizim për verifikim të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matës të energjisë elektrik.

##### **- Kryerja e vizitave monitoruese**

Gjatë vitit 2022 ishin planifikuar 14 vizita monitoruese dhe janë kryer 14 vizita monitoruese dhe janë grumbulluar të ardhura në masën e 260 000 lek pa TVSH.

#### **Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.126/2020 datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë".**

Gjatë vitit 2022 janë miratuar 2 (dy) Urdhëra të Ministrit përgjegjës për metrologjinë, konkretisht: Urdhëri nr.149, datë 19.05.2022 "Për miratimin e rregullores "Për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e personave juridikë dhe fizikë për kryerjen e shërbimit të riparimit të instrumenteve matëse, si dhe për monitorimin e aktivitetit/performances së tyre" dhe Urdhëri Nr.219, datë 21.09.2022 "Për miratimin e rregullores për verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara". Gjithashtu, ka përfunduar puna dhe janë në process miratimi 2 (dy) urdhëra të tjerë, konkretisht: Urdhëri "Për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar" dhe Urdhëri "Për përshkrimin e shenjës dalluese "instrument matës jo në përdorim" të instrumenteve matëse që janë në vendin e përdorimit, por nuk janë verifikuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë".

#### **Mirëmbajtja e instrumenteve që përdoren për verifikim.**

Kërkesa drejtuar Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI) për kalibrimin e instrumenteve matës të fushës së volumeve, që përdorin Specialistët e Sektorit të Shërbimit Nr.1, Tiranë, për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, në terren. Kërkesa drejtuar Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI) për kalibrimin e etaloneve të punës të fushës së masës, që përdorin Specialisti (Metrolog të Autorizuar) i Rrethit Kukës, i Sektorit të Shërbimit Nr.3, Lezhë, Sektorit nr.2, Pier dhe Sektorit nr.4, Korçë për ofrimin e shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, në terren.

Realizim i Kalibrimit të gjithë instrumentave matës që përdoren nga metrologët për kryerjen e procesit të verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, konkretisht: peshoret

elektronike të kapaciteteve të ndryshme, gramarë të klasave dhe kapaciteteve të ndryshëm dhe cilindra, si dhe për çdo instrument të kalibruar është lëshuar certifikata e kalibrimit.

#### **Bashkëpunime ndërinstitucionale**

##### **Kërkesë për informacion dhe bashkëpunime me:**

- 58 (pesëdhjetë e tetë) Drejtorive të Ujësjellës Kanalizimeve, konkretisht për të dhëna në lidhje me instrumentet matës ligjërisht të kontrolluar, matës uji;
- Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Administrimit të Mbetjeve (AKUM), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), për zgjidhjen e situatës së verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar, matës uji;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për instrumentet matës ligjërisht të kontrolluara, që kanë në përdorim dhe Dogëve Doganore për dhënie informacioni sipas kërkesave së tyre;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Bashkia Tiranë dhe Bashkisë Durrës për numrin e subjekteve taksi të licencuara nga ana e tyre, për mundësimin e mbulimit të plotë të verifikimit të taksimetrave nga DMI.;
- Autoritetin e Konkurrencës, për zbatimin e Vendimit Nr.36, datë 06.04.2022 të Këshillit Bashkiak "Për një ndryshim në vendimin Nr.3, datë 30.03.2009, të Këshillit Bashkiak "Mbi caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi të qytetit të Tiranës", të ndryshuar";
- Institucionet pjesë e funksionimit të Këshillit të Metrologjisë;
- Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) për subjektet të cilat nuk pranojnë ose/dhe pengojnë verifikimin e instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluara;
- Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë për njohje certifikatash kalibrimi për instrumentet matës të shpejtësisë, radar;

#### **Trajnime dhe zhvillim personal**

Për përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin profesional të stafit verifikues të instrumenteve matës janë miratuar programe trajnimi, të cilat janë miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM, konkretisht është miratuar urdhëri nr. 149, datë 06.04.2022 "Për organizimin e trajnimeve të nevojshme për zhvillimin e aftësive profesionale për specialistët (metrolog të autorizuar) të sektorëve të shërbimeve të DML-së", si dhe urdhëri nr.152, datë 08.04.2022 "Për miratimin e programit të trajnimit për punonjësit e rinj të DML-së". Gjatë 6-mujorit të parë vitit 2022 janë organizuar trajnime në fushën e parapaketimeve për punonjësit që ofrojnë këtë shërbim në 4 (katër) sektorët e shërbimeve të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore (DML-së). Gjithashtu, janë organizuar trajnime në fushën e masës në Sektorët e Shërbimeve të DML-së.

## **II. DREJTORIA E METROLOGJISË SIKENCORE DHE INDUSTRIALE**

1. Në mbështetje të planit të punës për vitin 2022, DMSHI ka realizuar kalibrime të instrumenteve matës sipas kërkesave të ardhura nga subjekte të ndryshme apo institucione shtetërore si më poshtë vijon:

Totali i kalibrimeve DMSHI janar - dhjetor 2022 (të jashtme + të brendshme) = 1712 instrumenta

Totali i kalibrimeve DMSHI janar - dhjetor 2022 (të jashtme) = 1132

instrumenta

Totali i kalibrimeve DMSHI janar - dhjetor 2022 (të brendshme) = 580 instrumenta

Totali i të ardhurave DMSHI janar - dhjetor 2022 = 18 494 997 lekë (pa tvsh)

## **2. Pjesëmarrje në Ndërkrahime, Trainime, Komitete Teknike**

### **Pjesëmarrje në Ndërkrahime**

Ndërkrahim bilateral ndër-laboratorik në fushën e presionit ndërmjet Laboratorit të presionit të DPM-së dhe Laboratorit të presionit të AMK Kosove (Raporti final nga lab i presionit DPM - Z.B. Tomçini- Shkurt 2022).

Ndërkrahime bilaterale të laboratorit të temperaturës me pilot EIM për pikat pozitive për termometrin dixhital dhe termometrin me rezistencë (50 deri në 250 gradë) (Raport final nga EIM- Maj 2022)

Ndërkrahim bilateral i laboratorit të lagështisë me pilot EIM për sensorët e temperaturës dhe lagështisë (Raport final nga EIM- Maj 2022).

Ndërkrahim i laboratorit të Gjatësisë me pilot EIM për Mikrometër dixhital 0-25 mm/0.001 mm dhe Kalibrë dixhital 0-300 mm/0.01 mm. (Raport final nga eksperti grek i EIM)

### **Trainime të jashtme**

-Workshop në fushën e matjeve elektrike, organizuar nga EIM, në kuadër të projektit DPM-PTB i fokusuar në automatizimin e matjeve të kalibratorit, konfigurimi i skemes në programin labview.

-Pjesëmarrje e të gjithë specialistëve të DMSHI-së në webinarin 1 ditor me temë "KCIDB 2.0 - Online technical exchanges on comparisons".

-Pjesëmarrje e anëtarëve të GNPIE-së në takimin online për kapitullin I "Levizja e lirë e mallrave".

-Pjesëmarrje e stafit të Sektorit të Masës & Densitetit në 9 webinare të organizuar nga ASPA.

-Pjesëmarrje në trajnimin virtual me temë "Gjurmueshmëria në matjet e densitetit të lëngjeve" zhvilluar në kuadër të EMPiR 17RPT02.

-Pjesëmarrje e specialistëve të DMSHI-së në trajnimin e organizuar nga Instituti SMIC për "Pjesëmarrje në ndërkrahime dhe përgatitjen e raporteve të tyre".

-Pjesëmarrje trajnimin virtual në lidhje me "Vlerësimin e Pasigurisë së Matjeve në Analizat Kimike" organizuar nga Universiteti Tartu Estoni.

-Pjesëmarrje e specialistëve të Sektorëve të DMSHI-së në trajnim virtual me temë Metodat e matjes, pasiguria dhe analizat statistikore në kuadër të EMPiR 18NETOS MATHMET.

-Pjesëmarrje e Drejtorit të DMSHI në takimin virtual të "57th CIPM Meeting" (CIPM International Committee of Legal Metrology).

-Pjesëmarrje e përgjegjësve dhe specialistëve të Sektorëve të DMSHI-së në trajnimin virtual "Good Governance/Towards a reliable and resilient National Quality Infrastructure" organizuar nga UNIDO.

### **Pjesëmarrje në Komitete teknike:**

Pjesëmarrje virtuale dhe me prezencë e personave të kontaktit të DMSHI-së në takimet vjetor të Komiteteve Teknik të Termometrise, Lagështisë, Rrjedhjeve, Masës dhe Njësive që Rrjedhin prej saj, Gjatësisë, Matjeve Elektrike TC-E.

### **Trainime të brendshme**

Trajnim i stafëve të reja të Sektoreve të Volumeve Rrjedhjeve dhe Kimisë (1 specialist), Matjeve Mekanike (2 specialiste), Matjeve Dimensionale (1 specialist), në baze të Planeve respektive të trajnimeve DPM-FO-08/9, miratuar nga drejtori i DMSHI-së.

Trajnim i brendshëm në fushën e masës, kryesisht i Metrologëve të rinj të Qendrave Rajonale Fier, Lezhë dhe Korçë nga Përgjegjësjë e Sektorit të Masës dhe Densitetit (Tetor-Dhjetor 2022).

### **3. Rishikimi i dokumentacionit të SMC:**

- Plotësimi i dokumentacionit të SMC në përputhje me standardin 17025:2017 nga të gjithë laboratorët e sektorëve të DMSHI. Rishikime procedurash teknike, formularësh nga laboratorët e DMSHI-së, plotësimi i tyre konform MC dhe procedurave operacionale të DPM-së.
- Plotësimi i dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë SMC sipas standartit 17025:2017 në laboratorët e Sektorëve të DMSHI-së, (rregjistrimeve teknike (shërbime kalibrimi) dhe ato të cilësisë konform formularëve përkatës, procedurave operacionale dhe teknike.
- Update-imi i formularëve të SMC të Laboratoreve të Sektoreve të DMSHI-së në përputhje kërkesat e SMC të DPM-së dhe standartit 17025: 17025
- Aplikimi i Veprimeve korrigjuese për gjetjet nga auditimet e mëparshme në laboratorët e presionit, elektrik, gjatësisë, temperaturës, lagështisë, masës etj.
- Plotësimi i formularëve të akreditimit (në anglisht) për laboratorët e temperaturës, elektrik, kimisë, gjatësisë, forca; sipas 2 modeleve të aplikimit për dy trupa akredituese të huaja (Dhjetor 2022).

### **4. Auditime të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë:**

Realizimi i auditimit të brendshëm të SMC në:

- Laboratorin e Masës, për kalibrimin e peshoreve NAWI + Lab. sekondar Laboratorit të Temperaturës (prill 2022),
- Laboratorin e Matjeve Dimensionale (prill 2022). në zbatim të kërkesave të standartit 17025:2017, sipas programit vjetor të auditimeve të brendshme të vitit 2022.
- Laboratorëve të temperaturës, lagështirës (7 Prill 2022), gjatësisë (datë 14.04.2022), takim online me ekspertet grek.

### **5. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet drejtorive, pjesëmarrja në grupe pune:**

- Kalibrimi i instrumenteve aksesore dhuratë nga PTB për laboratorin e lagështisë, në kuadër të projektit DPM-PTB-së, në EIM Greqi.
- Mbyllja e praktikës së kalibrimit të datalogerit të laboratorit elektrik, në kuadër të projektit DPM-PTB-së, në EIM Greqi.
- Realizimi i Kalibrimit të etaloneve primare të masës 1mg-10kg kl E1 (kalibruar si E0) në Institutin Kombëtar të Metrologjisë INRIM ITALI, Kostoja e shërbimit të kalibrimit u mbulua nga PTB në kuadër të Projektit të bashkëpunimit PTB-DPM.
- Pjesëmarrje e drejtorit të DMSHI-së në grupin e punës në lidhje me draft- rregulloren përfundimtare "Për Kriteret dhe Procedurat për Autorizimin e Personave Juridike për Kryerjen e Veprimtarive në Metrologjinë Ligjore dhe për Autorizimin e Personave Juridike dhe Fizike për kryerjen e Shërbimit të Riparimit të Instrumentave matëse dhe për Monitorimin e Aktivitetit/Performancës së tyre".
- Pjesëmarrje e Përgj. të Sektorit të Masës & Densitetit në grupin e punës në lidhje me draft- rregulloret përfundimtare "Për miratimin e Rregullores për Miratimin e Tipit të Instrumenteve Matës Ligjërisht të Kontrolluar" dhe "Për miratimin e Rregullores për Verifikimin e Instrumentave Matës Ligjërisht të Kontrolluar".
- Miratimi nga KM dhe publikimi në fletore zyrtare i VKM Nr. 261 Date 29.04.2022 "Për Njesite Baze të Sistemit Ndërkombëtar të Njesive (SI) që do të përdoren në Shqipëri, Njesite që rrjedhin prej tyre, Shumefishat dhe Nenfisat, Njesite Shtese të vendosura ndërkombëtarisht dhe menyra e përdorimit të tyre".
- Pjesëmarrje e specialistëve të fushave, elektrike, Volumeve dhe Mases të Sektoreve të DMSHI-së në vizitat vlerësuese të subjekteve "FDR" shpk, "NOA CONTROL" sh.p.k. "AI-INSPEKTIM" sh.p.k, NOA CONTROL" sh.p.k, Nr.125, datë 24.05.2021, për realizimin e vizitës monitoruese 1-

vjeçare të subjektit "AL-INSPEKTIM" sh.p.k, "SHPRESA-AL" sh.p.k, "TUNAMAR" shpk, M&M Topuzi shpk, "ALMETA GMBH"sh.p.k, "HIDROFAHO" sh.p.k, "MiscoM" sh.p.k, "NDP" sh.p.k, "ECIT" sh.p.k, Metro Alb" sh.p.k. Përgatitja e raporteve rekspektive të monitorimit dhe vleresimit.

- Pjesëmarrje e stafit të DMSH në grupe të ndryshme pune sipas urdherit të DP për hartim specifikimesh teknike për prokurimet e zhvilluara nga DPM gjatë vitit si dhe në komisione për inventarizimin e aseteve të DPM.

### **III. DREJTORIA E SIGURIMIT TË CILËSISË DHE PARAPAKETIMEVE**

#### **1) Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 126/2020 datë 15.12.2020 "Për metrologjinë".**

Në cilësinë e drejtimit të grupit të punës sipas Urdhërit të DP nr. 08 datë 06.01.2021 për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 126/2020 "Për Metrologjinë" gjatë vitit 2022 vijoi puna për rishikimin e draft - VKM për etalonet kombëtare të hartuar që në vitin 2021, me qëllim reflektimin e komentëve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Këshillit të Ministrave. Në periudhën Prill - Maj 2022 projektvendimi i rishikuar shoqëruar me relacionin përkatës u dërgua në MFE. Përfundimisht ky akt u miratua nga Këshilli i Ministrave si vijon:

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324 datë 18.05.2022 "*Për përcaktimin e kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësojë një standard matjeje për t'u deklaruar etalon kombëtar matjeje*", bazuar në nenin 12, pika 5 të Ligjit nr. 126/2020;

Gjithashtu në 6-mujorin e parë, në cilësinë e anëtareve të grupit të punës (sipas Urdhërit të sipërcituar) punonjësit e SSC dhanë kontribut për rishikimin e projekti akteve nënligjore që u miratuan gjatë kësaj periudhe, konkretisht:

- i. Urdhër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 149, datë 19.05.2022 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore*", bazuar në pikën 4 të nenit 39 të Ligjit nr. 126/2020;
- ii. Projekt - rregullore e brendëshme e organizimit dhe funksionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë e cila është dërguar zyrtarisht për mendim në MFE në Qershor 2022.

Përveç detyrave të planifikuara në programin vjetor 2022, gjatë këtij viti SSC ka dhënë kontribut dhe në një sërë çështjesh dhe detyrash që i janë ngarkuar në grupe pune, si:

- a. *Strategjia afatgjatë për zhvillimin Ekonomik dhe Integrimin 2022-2030 - pjesa e metrologjisë,*
- b. *Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit 2023-2030 - pjesa e metrologjisë*
- c. *Udhërrëfyes (roadmap) për përafrimin e legjislacionit me acquis të BE, në fushën e Lëvizjes të Lirë të Mallrave - pjesa e metrologjisë*

#### **2) Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas ISO 17025 dhe CIPM MRA, dhe Zgjerimi i aplikimit të SMC në laboratorë/fusla të tjera, në përputhje me proritetet/planin e Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale për vitin 2022.**

Gjatë vitit 2022 është evidentuar nevoja e rishikimit të dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit, konkretisht:

1. Manuali i Cilësisë së DPM, DPM-QM-01, version 11 datë 25.10.2022, me qëllim përditësimin e referencave ligjore, pas rishikimit dhe miratimit të akteve të reja ligjore për metrologjinë
2. DPM-PO-04 Procedura operacionale për ruajtjen e paanshërisë dhe të konfidencialitetit, version 06 datë 17.10.2022
3. DPM-PO-22 Procedura operacionale për organizimin dhe menaxhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë version 02 datë 17.10.2022

Krahas dokumentacionit horizontal të SMC, Sektori i Sigurimit të Cilësisë ka rishikuar të gjithë procedurat teknike që janë hartuar apo rishikuar nga sektorët/laboratorëte DMSII, në përputhje me kërkesat e SMC, në përputhje me prioritetet e planit vjetor 2022 të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, konkretisht:

- 1) LE-PT-01 "Procedurë Teknike për matësat energjisë elektrike aktive version 06, date 27.01.2022.
  - 2) LE-PT-09 "Procedurë Teknike për kontrollin e cilësisë në laboratorin elektrik" version 03, date 27.01.2022.
  - 3) LE-UP-08/1 "Udhëzues pune për përcaktimin e intervaleve të kalibrimit të pajisjeve të laboratorit elektrik", version 01, date.21.02.2022
  - 4) LT-PT-03 "Procedurë teknike për kalibrimin e termometrave qelqi" version 04, date 13.09.2022.
  - 5) LT-PT-06 "Procedurë teknike për kalibrimin e termometrave analoge dhe dixhital me lexim të drejtperdrejtë" version 03, datë 12.09.2022.
  - 6) LT-PT-09 "Procedurë teknike për kontrollin e cilësisë në laboratorin e temperaturës" version 02, datë 26.10.2022.
- Në funksion të përbushjes së kërkesave të SMC, u hartua Raporti vjetor i rishikimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (DPM-FO-07/2), i cili, u diskutua dhe miratua në mbledhjen vjetore mbajtur me datë 15.02.2022. Ky raport është hartuar mbështetur në procedurën operacionale DPM-PO-07 version 06 datë 04.03.2019 "Për rishikimin e Sistemit të Menaxhimit". Bazuar në diskutimet, vendimet dhe konkluzionet e kësaj mbledhje u hartuan minutat përkatëse që përfshijnë dhe planin e veprimit (DPM-FO-07/3\_10.03.2022 referuar vendimeve të marra në këtë takim.
  - Grupi i Menaxhimit të Risikut i ngritur me Urdhërin nr. 9 datë 04/01/2019, ka rishikuar statusin e veprimeve të ndërmarra me qëllim eliminimin apo minimizimin e rrisqeve bazuar në metodologjinë e përshkruar në procedurën operacionale DPM-PO-23, si dhe ka plotësuar regjistrin e Risikut & planin e trajtimit të rrisqeve (DPM-FO-23/2\_17.02.2022) të cilat u prezantuan dhe miratuan në mbledhjen vjetore të rishikimit të menaxhimit dhe kanë qenë objekt rishikimi, në varësi të aktiviteteve të ndërmarra gjatë gjithë vitit 2022.
  - Në mënyrë sistematike janë plotësuar dhe mirëmbajtur regjistrimet e nevojshme të cilësisë dhe ato teknike, bazuar në Politikën e Cilësisë dhe procedurat e dokumentuara të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Këto regjistrime lidhen me personelin (kompetencën, trainimet autorizimet, programi vjetor i trainimeve) auditimet e brendëshme, pajisjet (inventari i pajisjeve, plani i mirëmbajtjes, programi i kalibrimeve për vitin 2022, regjistri i softuare dhe harduare për çdo laborator të DMSII, programi afatgjatë i pjesëmarrjes në ndërkrahime laboratorike, aftësitë matëse dhe kalibruese të laboratorëve, etj).

### **3) Realizimi i Rishikimit vjetor të Menaxhimit të Sistemit të Cilësisë**

- Gjatë periudhës Janar - Shkurt 2022 u hartua raporti i rishikimit të Menaxhimit të Cilësisë për aktivitetin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë gjatë vitit 2021, në përputhje me politikën e DPM dhe të procedurës operacionale DPM-PO-07, version 06, datë 04.03.2019 "Për rishikimin e menaxhimit", i cili u diskutua dhe miratua në takimin vjetor të rishikimit të menaxhimit mbajtur më datë 15.02.2022. Minutat e kësaj mbledhje janë regjistruar në dokumentin DPM-FO-07/3 datë 10.03.2022.
- Në zbatim të procedurës së Komitetit Teknik për Cilësinë të EURAMET, u hartua raporti i performancës së Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM-së për vitin pararendës. Ky raport u dërgua dërgua pranë Komitetit Teknik të Cilësisë të EURAMET në muajin mars 2022 dhe u miratua prej tij. Raporti është i aksesueshëm në faqen e internetit të EURAMET, në përputhje me strukturën e kërkuar në Udhëzuesin G-TCQ-PR-005 të këtij komiteti.
- SSC ka bashkëpunuar ngushtësisht me Drejtorinë e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, ku i është dhënë mbështetja e nevojshme në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë nëpërmjet rishikimit të dokumentacionit teknik të hartuar, planifikimit dhe organizimit të auditimeve të

brendëshme, trainimeve për personelin, plotësimin dhe përditësimin e gjithë regjistrave lidhur me shërbimet e kalibrimit, etj.

**4) Planifikimi, organizimi dhe zbatimi i vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë**

**a) Vlerësimi i jashtëm**

Gjatë vitit 2022 me mbështetjen financiare dhe ekspertizën teknike të mundësuar nga projekti i asistencës së PTB për DPM, u organizuan 5 ndërkrahime laboratorike konkretisht 3 ILC në fushën e temperaturës, 1 ILC në fushën e lagështirës dhe 1 ILC në fushën e matjeve dimensionale. Këto ILC u kordinuan dhe pilotuan nga instituti Grek i Metrologjisë EIM. SSC dhe gjithë mbështetjen e nevojshme për organizimin me sukses të tyre. Në muajin dhjetor punonjësit e laboratoreve të temperaturës, matjeve elektrike dhe gjatësisë plotësuan 9 pyetsore vetem për pjesën teknike (pyetsoriët e dy trupave potenciale për akreditim). Megjithatë, vlerësimi i kompetencës teknike të këtyre laboratoreve nga një palë e tretë (trupë akredituese nëshkruese e marrëveshjes së njohjes së ndërsjellë në nivel rajonal ose ndërkombëtar (EA-MLA/ILAC-MLA) për kalibrimin nuk u bë i mundur gjatë vitit 2022 dhe nuk u sigurua plotësisht për disa fusha, gjurmueshmëria e matjeve sipas ISO/IEC 17025:2017 dhe CIPM MRA.

**b) Vlerësimet e brendëshme**

Bazuar në Programin vjetor të auditimeve të brendëshme DPM-FO-06/1\_12.01.2022 janë realizuar auditimet e brendëshme në laboratorët DMSHI, të cilat kanë pasur për qëllim:

a) Verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e ISO / IEC 17025: 2017 dhe CIPM MRA;

b) Zgjerimin e fushave që zbatojnë kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë; si dhe

c) Mbledhjen e informacionit për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të SMC

Gjetjet e konstatuara dhe evidentuara nga të gjithë auditimet e brendëshme janë regjistruar në regjistrin e jo-konformiteteve, ankesave dhe veprimeve korrigjuese DPM-FO-09/2. Labororet e DMSHI janë në proces të implementimit të veprimeve korrigjuese përkatëse për një pjesë të tyre, ndërkohë që pjesë e konsiderueshme e tyre janë akoma të pazgjidhura.

**5) Organizimi, kordinimi dhe menaxhimi i kërkesave të klientëve për shërbime kalibrimi në përputhje me politikën e SMC të DPM**

Spektori i Sigurimit të Cilësisë ka kordinuar, plotësuar dhe mirëmban në mënyrë sistematike regjistrat që lidhen me kërkesat e klientëve për shërbime kalibrimi në përputhje me politikën e Cilësisë së DPM. Plotësimi dhe komunikimi i ofertave financiare, regjistrimet e vlerësimeve të shërbimeve të ofruara, në bashkëpunim me sektorët/labororet e DMSHI.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022. Spektori i Sigurimit të Cilësisë ka regjistruar dhe trajtuar 332 kërkesa të subjekteve për shërbime kalibrimi. Të gjitha kërkesat janë ndjekur duke zbatuar Manualin e Cilësisë të DPM-së si dhe procedurat DPM-PO-19 "Procedurë operacionale për rishikimin e shërbimeve të konsumatorit" dhe DPM-PO-16 "Procedurë operacionale për trajtimin e pajisjeve për kalibrim". Të gjithë subjekteve u është dërguar për plotësim forma e pranimit të ofertës financiare DPM-FO-19/2 dhe mbas konfirmimit nga ana e tyre, DMSHI ka planifikuar shërbimet përkatëse. Disa subjekteve nuk u është ofruar shërbimi i kalibrimit për arsye të ndryshme (mungesë gjurmueshmërie nga DPM, mosplotësim i parametrave metrologjikë të instrumentit ose subjekti ka terhoqur kërkesën me dëshirën e tij. Gjithë procesi i punës është i pasqyruar në regjistrat përkatës DPM-FO-19/2 "Regjistri i kërkesave të klientëve për shërbimin e kalibrimit" si dhe DPM-FO-16/2 "Regjistri i urdher porosive për kalibrim" të cilat gjenden në intranetin e DPM-se .

Është mbajtur korrespondenca me subjektet kerkues të shërbimeve të kalibrimit duke i kthyer përgjigje të gjithë e-maileve të ardhur në adresën zyrtare metrology@dpm.gov.al, si dhe përcjelljen e e-maileve të tjera në drejtorite përkatëse sipas problematikes.

Regjistrat e detajuar të shërbimeve të kalibrimit janë në dispozicion në format elektronik në intranet dhe janë objekt i vlerësimit gjatë rishikimit të menaxhimit që kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas Politikës së Cilësisë.



Gjithashtu, here pas here me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, specialistet e Sektorit të Sigurimit të Cilësisë janë angazhuar në grupe pune si me poshte:

1. Urdhër nr.6 date 07.01.2022 "Per hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e vleres limit per prokurimet qe do te zhvillohen gjate vitit 2022", Per objektin e prokurimit "Blerje kancelarie". Si pjese e grupit te punes ne zbatim te ketij urdheri, u hartuan specifikimet teknike dhe llogaritja e fondit limit te pasqyruara ne memon nr.28/3 date 21.01.2022 dhe ne memon nr.366 date 09.03.2022 "Per rishqyrtimin e perlllogaritjes se fondit limit" pasi procedura nuk u realizua per pamjaftueshmeri fondi. Zbatimi i ketij urdheri perfundoi me marrjen ne dorezim te mallrave sipas procesverbalit perkates.
2. Urdhër nr.69 date 10.02.2022 "Per disa ndryshime ne Urdherin nr.6 date 07.01.2022", per objektin e prokurimit "Blerje materiale pastrimi, ngrohje dhe ndricimi".
3. Urdhër nr.353 date 06.10.2022 "Per kryerjen e inventareve", ne Sektorin e Shërbimit nr.4 Korçe., Ne-zbatim te ketij Urdheri grupi i punes realizoi shërbimin ne Sektorin e shërbimit Korçe nga data 14-18 Nentor 2022.
4. Urdhër nr.395 date 09.11.2022 "Per ngritjen e grupit te punes per hartimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit dhe llogaritjen e vleres limit per shërbimin e transportit te punonjeseve te DPM-se me autobus per vitin 2023". Si pjese e grupit te punes ne zbatim te ketij urdheri, u hartuan specifikimet teknike, kriteret e kualifikimit dhe llogaritja e fondit limit te pasqyruara ne memon nr.2197/1 date 18.11.2022 dhe proces verbalin perkates.

#### **6) Rritja, zgjerimi dhe përmirësimi i njohurive mbi SMC të DPM**

Gjate vitit 2022 Sektori i Sigurimit të Cilësisë ka organizuar si dhe ka marrë pjesë në disa aktivitete trainuese, përfshi pjesëmarrjen në mbledhjen vjetore (online) të Komitetit Teknik të Cilësisë së EURAMET në Prill 2022.

#### **7) Implementimi i kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012 "Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim" në sektorët e shërbimit të DML në përputhje me programin vjetor të kësaj drejtorie.**

Në përmbushje të detyrave të programuara për vitin 2022 si dhe në zbatim të Urdhërit të DP nr. nr 31 date 24.01.2022, është punuar për hartimin e dokumentacionit të Sistemit të menaxhimit sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012, me qëllim implementimin e tyre në metrologjinë ligjore. Konkretisht është hartuar Manuali i Cilësisë DPM-QM-02, version 01 date 14.06.2022, i cili është deguar për mendim tek strukturat eprore. Gjithashtu ka vijuar puna për hartimin e procedurave ooperative. Paralelisht me hartimin e dokumentacionit të SMC të DPM si trupë inspektuese, SSC ka hartuar materialet trainuese me temë "Njohja me kërkesat e Standardit SSI ISO/IEC 17020:2012 "Vlerësim i konformitetit - Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim" për punonjësit e Sektoreve të Shërbimit të Metrologjisë Ligjore:

- Tema 1: Hyrje, objektivat e trainimit dhe shpjegime mbi terminologjinë e ISO/IEC 17020:2012.
- Tema 2: Kërkesat e përgjithëshme në lidhje me paanshmërinë, konfidencialitetin dhe pavarësinë e trupave inspektuese.
- Tema 3: Kërkesat për burimet e nevojshme për të funksionuar njëtrupë inspektuese.
- Tema 4: Kërkesat e procesit të inspektimit (procedurat e verifikimit, regjistrimet, ankesat).
- Tema 5: Kërkesat e menxhimit dhe administrimit të një trupë inspektuese.

Trainimet u organizuan 22-23.09.2022 në Sektorin e Shërbimit Fier, më 4.10.2022 në Sektorin e Shërbimit Lezhë, dhe në datat 14-15.11.2022 në Sektorin e Shërbimit Korçe. Për punonjësit e trajnuar janë shpërndarë certifikatat përkatëse të trainimit.

### 8) Detyra të caktuara me Urdhëra të vecantë të Drejtorit të Përgjithshëm:

Janë realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara si anëtare të komisioneve për autorizim dhe monitorim të subjekteve të autorizuar për kryerjen e aktiviteteve në metrologjinë ligjore. Konkretisht, specialistja K. Luli gjatë periudhës Janar - Nëntor 2022 (është larguar nga DPM) ka marrë pjesë në të gjithë grupet e punës së ngritura nga Drejtori i Përgjithshëm në lidhje me autorizimin e subjekteve për të kryer veprimtari në metrologjinë ligjore, apo për monitorimin periodik të subjekteve tashmë të autorizuar, në përputhje me Urdhërin e Ministrit të MZHE-TS Nr.7025, datë 24.08.2017 « Për miratimin e rregullores për autorizimin e personave juridikë... » i zëvendësuar me Urdhërin nr. 149 datë 19.05.2022 të Ministrit të MFE "Për autorizimin e subjekteve që kryejnë veprimtari në metrologjinë ligjore". Në fund të çdo procesi grupet e punës kanë raportuar direkt tek Drejtori i Përgjithshëm në lidhje detyrat e ngarkuara.

*Per sektorin e parapaketimeve eshte realizuar:*

#### 1. Pergatitja e akteve nen-ligjore per parapaketimet dhe shishes enenatese

Eshte miratuar urdhri i Drejtorit te Pergjithshem nr. 45, date 31.01.2022 "Per miratimin e rregullores "Per shqyrtimin e aplikimeve per miratim, regjistrim dhe monitorim te sistemit te kontrollit sasior te prodhuesve te parapaketimeve me shenje konformiteti".

#### 2. Miratimi i sistemit te kontrollit sasior te prodhuesve te parapaketimeve.

Ne DPM gjate vitit 2022 asnje subjekt prodhues i parapaketimeve nuk ka sjelle kerkese per miratim sistemi. Sektori i parapaketimeve pergjate gjithë vitit ka kryer fushat ndergjegjesuese ne bizneset, paketuese te parapaketimeve gjate sherbimeve te kryera per verifikimin e dozatoreve ne mbeshtetje te S.Sh.Nr.1, mbi vendosjen e shenjes se konformitetit.

Ne kuader te plotesimit te laboratorit me materiale me burim te jashtem gjate vitit 2022 eshte realizuar perkthimi dhe njohja me guidat e reja te publikuara nga OIML dhe WELMEC konkretisht:

- Eshte perkthyer dhe pershtatur ne shqip, standardi ISO 17065 "Vleresimi i konformitetit kërkesat për organizmat që certifikojnë produktet proceset dhe shërbimet".
- Eshte perkthyer dhe pershtatur ne shqip guida e WELMEC 6.8 "Pesha e kulluar, peshave të kulluara të lara dhe peshave të kulluara të deglazuara.
- Eshte perkthyer dhe pershtatur ne shqip, rekomandimi nderkombetar OIML D-32 "Udhëzues për aplikimin e ISO/IEC 17065 në vlerësimin e organizmave certifikues në metrologjinë ligjore".

#### 3. Bashkëpunimi me DML.

Ne zbatim të urdherit të D.P. nr.29, datë 19.01.2022 "Për ngarkim me detyre shtese" sektori i parapaketimeve gjate vitit 2022 ka kryer kontroll statistikor ne linjat e paketimit te parapaketimeve ne mbeshtetje te metrologjeve te sektoreve te sherbimit te DML-se, (Sektori i Sherbimit Nr.1) duke realizuar anen teknike ne 317 matje, konkretisht:

Qyteti	Subjekte	Protokoll-matje
Tirane	99	209
Durres	20	84
Elbasan	7	9
Kavaje	6	8
Kruje	3	7
<b>TOTALI</b>	<b>135</b>	<b>317</b>

#### 4. Trajnime dhe pjesmarrje ne grupe pune.

- Sektori i parapaketimeve ka mare pjese ne trajnimet dhe aktivitetet ndergjegjesuese si me poshte:

- Pregatitje e planit te trajnimit te personelit te ri, Znj. Kaltrina Deda sipas memos nr. 300/2 prot. date 04.02.2022.

- Pregatitje e planit I vjecar te punes, ne date 11.08.2022 per specialisten e re te sektorit te parapaketimeve, znj. Shilda Dulaj. Gjithashtu znj. Dulaj miremban edhe rrejetet sociale te institucionit.

- Ne mbeshtetje te Urdhrit te D.P. nr. 152, date 08.04.2022 "Per miratimin e programit te trajnimit per punonjesit e rinj te DML-se" si dhe kerkeses me email-it te Z. Roland Kodra, Pergjegjes i Sektorit te Sherbimit Nr.4 Korçe, date 08.04.2022, protokolluar me nr. 738 prot. date 11.04.2022, u zhvillua trajnimi i specialistit metrolog te ketij sektori, Z. Shaziman Hoxha. Trajnimi u zhvillua ne datat 11-12/04/2022 dhe konsistoi ne marrjen e njohurive te pergjithshme teorike dhe praktike ne lidhje me kontrollin sasior te produkteve te parapaktuara.

- Në datën 26.05.2022 u zhvillua trajnimi i metrologëve të sektorëve të Shërbimit Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr.3, përkatësisht të Z. Ajet Xhemollari, Z. Astrit Sineci dhe Z. Sadik Smajlaj, të caktuar në DPM për shërbimet metrologjike në fushën e parapaketimeve dhe shisheve enëmatëse. Ata gjatë këtij trajnimi morën njohuri të përgjithshme teorike dhe praktike në lidhje me kontrollin sasior të produkteve te parapaktuara.

Ne kuader te kap.I "Lovizja e Lire e Mallrave", si pjese e GNPIE-se eshte realizuar rishikimi i analizes se LGA-Analiza e Mangesive Ligjore dhe IAGA- Analiza e Mangesive Institucionale e Administrative.

Gjithashtu eshte siguruar pjesmarrja ne trajnimet:

- Horizontal Measures of Free Movement of Goods organizuar ne date 21.04.2022 në ambientet e "Hotel Tirana International", Tiranë.
- General framework in the area of Chapter I - Free Movement of Goods, organizuar ne date 31.03.2022 në ambientet e "Hotel Tirana International", Tiranë.
- General Principles of Free Movement of Goods organizuar ne date 19.04.2022. nëpërmjet platformës Webex (online).

-Trajnim per punonjesit e Agjensisë te Metrologjisë së Kosovës, në datat 20-21 shtator, ne fushën e parapaketimeve, Bashkëpunimi eshte i vazhdueshem dhe do te vazhdoje me procedurat e miratimit dhe monitorimit të sistemit të kontrollit sasior të parapaketimeve me shenjë konformiteti dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta.

## **5. Bashkëpunim me drejtorite e DPM-se dhe zbatimi i detyrave bazuar ne urdherat e Drejtorit te Pergjithshem.**

Sektori i parapaketimeve ka bashkëpunuar me DML dhe DBNJ&SH pergjate gjithë vitit 2022, perkatesisht detyra shtese si:

- Eshte zbatuar Urdheri i D.P me nr.14, date 13.01.2022, per ngritjen e komisionit te vleresimit te ofertave per proceduren e prokurimit me objekt "Sherbimi i transportit me autobus, te punonjesve te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise".
- Eshte zbatuar Urdheri i D.P me nr.29, date 19.01.2022 "Per venien ne efience te plote te sektorit te parapaketimeve" ku jane realizuar trajnime teoriko-praktike ne lidhje me produktet e parapaktuara per Specialistet Metrolog qe mbulojne keto sherbim, ne sektoret e Sherbimit te DML-se.
- Eshte zbatuar Urdheri i D.P me nr.32, date 21.02.2022 "Per ngritjen e grupit te punes per hartimin e specifikimeve teknike dhe perlogaritjen e fondit limit per blerje pajisje informatike".
- Eshte zbatuar urdheri i D.P me nr. 221, date 10.06.2022 "Per hartimin e specifikimeve teknike, hartimin e kriterëve per kualifikim dhe perlogaritjen e vleres se fondit limit per riparimin e sistemeve te alarmit te zjarrit".
- Eshte zbatuar Urdheri i D.P me nr. 329, date 19.09.2022 per ndjekjen e zbatimit te kontrates me objekt "Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike ne objektin e Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise".

- Eshte zbatuar Urdhëri i D.P me nr. 362, date 12.10.2022 "Per hartimin e specifikimeve teknike, hartimin e kriterëve per kualifikim" dhe perlogaritjen e vlerës së fondit limit per riparim fotokopje".
- Eshte zbatuar Urdhëri i D.P me nr. 407, date 30.11.2022 per ngritjen e komisionit te vleresimit te ofertave "Sherbim i transportit te punonjësve te institucionit me autobus".
- Eshte zbatuar Urdhëri i D.P me Nr. 423, date 13.12.2022 "Per caktim perfaqesuesi per SQDNF.
- Eshte zbatuar Urdhëri D.P me Nr. 430, date 22.12.2022 "Per percaktimin e specifikimeve teknike, kriteret e kualifikimit dhe perlogaritjen e fondit limit per "Sherbim interneti, per vitin 2023".

#### **IV. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve ka realizuar këto detyra per vitin 2022:

##### **Sektori Juridik, Integrimit Dhe Komunikimit**

###### **Realizimi i Prokurimeve Publike**

- Hartim i Regjistrit te Realizimit te Prokurimeve Publike per vitin 2021, per 4 mujorin e pare dhe 4 mujorin e dyte te vitit 2022, si dhe dergim ne MFE.
- Hartim i Regjistrit te Parashikimeve te Prokurimeve Publike per vitin 2022 dhe dergim ne MFE dhe Degen e Thesarit Tirane, ne forme te shkruar dhe elektronike.
- Hartim i Regjistrit te Parashikimeve te Prokurimeve Publike per vitin 2022 te cilat do te zhvillohen ne menyre te perqendruar nga Organi Qendror Bleres prane Ministrise se Brendshme.
- Urdher per ngritjen e grupeve te punes per hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit.
- Hartim i Regjistrit te Realizimit te Prokurimeve Publike per katermujorin e pare dhe te dyte te vitit 2022 dhe dergim ne MFE
- Shtese regjistri per parashikimet e prokurimeve publike
- Zhvillimi dhe realizimi i procedurave me vlerë te vogel, per objektet sipas regjistrit te parashikimeve
  - Sherbim interneti
  - Mirembajtje e faqes web
  - Blerje uje i pijshem
  - Blerje materiale ngrohje dhe pastrimi
  - Blerje kancelari
  - Siguracion godine
  - Siguracion automjetesh
  - Blerje tonera
  - Blerje dokumentacion specifik
  - Riparim ashensoresh
  - Riparim fotokopje
  - Rimbushje dhe kolaudim i bomblave te zjarrit
  - Furnizim me materiale dhe sherbime speciale per DMSHI
  - Riparim i fasadave te xhamave
  - Riparimin e sistemit te kondicionimit ne katet 1, 2, 0, -1, -2
  - Për sistemin dinamik te biletave të transportit ajror ndërkombëtar "Blerje bileta avioni" sipas grafikut te miratuar nga Ministri i MFE-se,
  - Mirembajtje e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave te punes (riparim i sistemit te alarmit)
  - Mirembajtje e pajisjeve te zyres (upgrade dhe mirembajtje e pajisjeve fiskale te perdorura nga metrologet).

- Mirembajtje vepra ujore, hidraulike dhe elektrike (Mirëmbajtje të veprave ujore, hidraulike dhe elektrike (Riparinim e pompave zhytëse, ngritëse, tubacioneve të rejtit hidraulik, valvulave hidraulike, riparim filtrash).

#### Prokurime

- Sigurim i transportit të punonjësve të institucionit
- Hartim i kontrates për objektin "Mirembajtje e mjeteve të transportit", pjesë e Matrevoshjes Kuader
- Dergim në MFE dhe Ministrinë e Brendshme (ABP) i kërkesës me dokumentacionin përkatës për objektin "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1"
- Hartim kontrate, formular zbatim kontarte dhe urdher për ndjekje zbatimi
- Dergim në MFE dhe Ministrinë e Brendshme (ABP) i kërkesës me dokumentacionin përkatës për objektin "Riparim, mirembajtje e automjeteve të DPM-se"
- Hartim kontrate, formular zbatim kontarte dhe urdher për ndjekje zbatimi
- Dergim në MFE dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (OQB) i kërkesës me dokumentacionin përkatës për objektin "Blerje kurti dhe dosje për ruajtje të perhershme"
- Hartim kontrate, formular zbatim kontarte dhe urdher për ndjekje zbatimi
- Dergim në MFE dhe AKSHI i kërkesës me dokumentacionin përkatës për objektin "Blerje pajisje informatike"
- Hartim kontrate, formular zbatim kontarte dhe urdher për ndjekje zbatimi për "Blerje kompjutera"
- Hartim kontrate, formular zbatim kontarte dhe urdher për ndjekje zbatimi për "Blerje fotokopje"
- Dergim në APP i formulareve të zbatimit të kontrates, për procedurat e realizuara
- Kontrate "Security" me shoqërinë "Illyrian Guard" sha

#### Pjesëmarrje në Grupe Punë

Pjesëmarrje në grupet e punës "Për autorizim dhe monitorim të subjektet e e autorizuar".

#### Detyra të ndryshme

Hartim i kontrates së dhënies me qera të Zyres Vlorë, Peqin.

Dergim në MFE, i statusit të projektakteve të PPAP 2022 dhe rekuizet e ushtruara pranë Gjykatës së Lartë.

#### Dhënie mendimi për projektaktet e dërguara nga institucione të tjera

-Dhënie mendimi dhe dergim të komenteve pranë MFE, për projektvendimin "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024 (PKIE 2022-2024).

-Dhënie mendimi dhe dergim të komenteve pranë MFE, për projektvendimin "Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online, nga institucionet dhe për metodologjinë e monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarive administrative të ofrimit të tyre"

#### Akte nenligjore dhe ndjekja e procedurës së miratimit të tyre

Raportim në MFE për statusin/fazën e miratimit të akteve nenligjore, të dalta në zbatim të Ligjit për Metrologjinë.

#### Trajnime

Trajnim me temë "Funksionimi i sistemit të ankesave elektronike"

Trajnim pranë ASPA me temë "Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël"

Trajnim si pjesë e GNPIE, për Kapitullin I "Levizja e lirë e mallrave"

Trajnim pranë MFE me temë "Levizja e lirë e mallrave"

Trajnim online të Grupit Nderinstitucional të Punës, për Integrimin Evropian

#### Ndjekje e Proceveve gjyqësore pranë:

- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse: Plus communication,

- Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, palë e paditur : Altin Beraj

- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me pale paditese: Faton Meka,
- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me pale paditese: Hamide Bitri
- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me pale paditese: Jonufria 2000"
- Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë me pale paditese: Batjon Begaj, ortak me 51% të Kiotave të "Shoqëria "Certified Solutions Corporation" sh.p.k dhe Shoqëria "Certified Solutions Corporation" sh.p.k me administrator Venagjar Begaj.
- Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me pale ankuese DPM, për Durim Grabova.
- Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me pale paditese: Durim Grabova
- Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë me pale paditese Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për Kompaninë Transportuese "BENINPEX &CO", Kompania Transportuese "DHI," dhe Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Vlorë me pale paditese: Shoqëria "ARTI 2012" shpk

**-Rakordim periodik** me Sektorin e Financës dhe Buxhetit lidhur me arkëtimin e 16 gjobave me vlerë 1 567 800 leke nga shoqëria përmbarimore TDR shpk.

- *Rakordime me të gjitha Shoqëritë Përmbarimore dhe Zyrat e Përmbarimit Shtetëror në të cilat DPM ka dërguar për ekzekutim vendimet e gjobave.*

- *Duke i kërkuar rëfillim të procedurave të ekzekutimit për ato tituj të cilët kanë qenë të pezulluar për shkak të mungesës së pasurisë dhe informacionit lidhur me fazën në të cilën ndodhet ekzekutimi i çdo Urdhër Ekzekutimi - Vendim Gjobe si më poshtë.*

Shkresë nr prot 833 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Shkoder.

Shkresë nr prot 825 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Strati Bailif Service shpk

Shkresë nr prot 826 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Lushnje.

Shkresë nr prot 827 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Tiranë.

Shkresë nr prot 828 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Justitia.

Shkresë nr prot 830 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore Gjirokastrë.

Shkresë nr prot 831 datë 27.04.2022 drejtuar Zyres Përmbarimore TDR shpk.

-Nga shoqëria përmbarimore "TDR GROUP" është vendosur selia e konservativë (për periudhën janar - dhjetor 2022), për 17 subjekte dhe janë në proces 23 Gjoba për subjekte të ndryshme.

-Nga Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFF'S SERVICE" shpk me shkresën nr.5521 datë 02.12.2022, "Kthim përgjigje shkresës me nr.1760 prot datë 12.09.2022 " përmbaruesi na vë në dijeni se nuk gjendet pasuri dhe ka pezulluar veprimet përmbarimore, për të gjitha vendimet e gjobave që ndiqen nga kjo shoqëri përmbarimore.

-*Ridërgim kërkesesh për Urdhërat e Ekzekutimit Për subjektin "CEZ Shpërndarje" sh.a janë dërguar pranë TDR Group më datë 14.12.2022 për vendimet e cituara si më poshtë:*

Pranë Sherbimit Përmbarimor 'TDR Group', janë ridërguar kërkesa për ekzekutim për 75 Urdhëra të ekzekutimit për gjobat e vitit 2011 dhe 108 për gjobat e vitit 2012, vendime gjobash të lëna në fuqi nga gjykata dhe të cituara si më poshtë:

-Referuar Udhëzimit nr.1, datë 26.05.2022 "Për përcaktimin e rregullave për heqjen dorë nga Rekursët e depozituar nga administrata shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të pashqyrtuara

nga Gjykata e Lartë, për disa çështje me natyrë civile dhe administrative”, janë depozituar pranë Gjykatës së Lartë kërkesat për heqje dorë nga disa rekurseve të DPM-se .

- Shqyrtim dhe kthim pergjigje i te gjitha kerkesave te cilat kane ardhur nepermjet platformes E-Albania.

*-Njoftim per shlyerje detyrimi te debitoreve te shpallur nga DPM per DVP Kukes Komisarati Tropoje, Djellza Kompani Fushe Arrez, Fakulteti i Mjekesise dhe Veterinarise, Kantina Jahja.*

Brenda vitit te gjithë keta debitore kane kryer pagesat ne menyre vullnetare prane sektorit te Finances ne DPM duke bere keshu mbylljen e te gjithë detyrimeve.

- Anetare e grupit te punes sipas urdherit Nr 137 date 23.03.2022 caktimit si perfaqesuese e DPM-se per tu pajisur me nenshkrim elektronik per SQDNF.

- Sipas urdherit Nr 376 date 20.10.2022, ne cilesine e koordinatores per te drejten e informimit dhe mbrojtjen e te dhenave personale.

### Sektori i financës & buxhetit.

Sektori i Financës në përputhje me planin e punës për muajin Janar- Dhjetor 2022, ka realizuar detyrat e mëposhtme:

-Sektori gjatë muajit Shkurt, Mars 2022 punoi dhe hartoi pasqyrat përfundimtare të Bilancit të vitit 2021 dhe bëri dorëzimin e tyre në Drejtorinë e Thesarit Tiranë dhe në Ministrinë e Financave & Ekonomisë.

-Rakordimi me Degën e Thesarit Tiranë të shpenzimeve mujore dhe progresive për vitin 2022.

-Përpilimi i listepagesës së sigurimeve shoqërore , sigurimeve shëndetësore dhe tatimeve të pagës së punonjësve të DPM-së si dhe përfundimi i deklarimit on-line të tyre, llogaritjen e raporteve ditore dhe të raporteve të paafësisë së përkohshme në punë si (leje lindje), plotësimin e librezave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

-Nxjerja dhe hartimi i pasqyrave për punonjësit e DPM-së për efekt pensioni sipas kërkesave të punonjësve dhe të ish punonjësve.

-Hartimi i Urdhër Shpenzimeve për të gjithë aktivitetin e DPM-së në Lekë dhe në Valutë.

-Hartimi dhe raportimi i evidencave të ndryshme në Drejtorinë, Thesar dhe në Ministri.

-Pret gjatë gjithë muajit faturat me Tvsh për DMSHI dhe DML si dhe faturat e fiskalizuara sipas kërkesave e subjekteve.

-Hartimi i librit të shitjes së DMSHI-së, hartimi i totalit të librit të shitjes së DPM-së si dhe deklarimi i tij në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë, Deklarimi i TVSH, brenda afateve të caktuara.

-Hartimi listë pagesës së punonjësve të DPM-së dhe deklarimi i Tatimit të pagës dhe Sigurimeve shoqërore & shëndetësore në sistemin e Tatimeve, brenda afateve të caktuara.

-Raportimi i evidencës së të ardhurave mujore dhe progresive sipas Sektorëve të shërbimeve, DMSHI-së dhe Totali DPM-së.

-Rakordim me Degën e Thesarit për të ardhurat e muajit dhe progresive për vitin 2022.

-Mban dhe administron kartelat personale të inventareve të personelit të DPM-së duke reflektuar dhe levizjet përkatëse gjatë periudhës.

-Rakordon me shëfën e financës inventaret sipas llogarive përkatëse në funksion të nxirjes përfundimtare të totalit të llogarive të Bilancit.

-Kuadrimi i faturave me TVSH dhe të fiskalizuara me librin e shitjes, regjistrimi i serive të faturave për çdo metrolog.

-Kontrolli dhe regjistrimi i dokumentacionit të magazinës, regjistrimi i tyre në kartelat dyfishë dhe në kartelat personale të punonjësve sipas kontabilitetit, dhe kontabilizimi i tyre.

-Rakordon me punonjësën e të ardhurave për derdhjet e Metrologëve.

-Rakordimi me Magazinën për gjendjen e çdo fund muaji sipas kartelave.

- Kontabilizimin e të ardhurave sipas sektorëve dhe natyrës së tyre duke nxierë gjendjen mujore të secilës llogari.
- Regjistrimi i serive të faturave me TVSH për çdo Metrolog.
- Rakordimi mes specialisteve të financës që kontrollojnë të ardhurat për rakordimin e derdhjeve të Metrologëve dhe subjekteve gjatë muajit.
- Bërjen e çdo detyre tjetër të ngarkuar nga Drejtori i Drejtorisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm.
- Bashkëpunimi me Sektorët e ndryshëm të Drejtorisë.

#### **Treguesit e DPM-së sipas llogarive deri më 31.12.2022.**

	<b>Plan 2022</b>	<b>Fakt 2022</b>
	<b>Vjetor</b>	<b>12 Mujor</b>
Llog. 600	77 738 440	77 674 801 lekë.
Llog. 601	12 955 000	12 952 189 lekë.
Log. 602	27 655 200	26 327 802 lekë.
Log. 605	4 000 000	3 999 325 lekë.
Llog. 606	1 766 000	1 754 800 lekë.
Log. 602/Ardh	10 000 000	5 094 785 lekë.
Llog 466	0	15 636 095 lekë.
Llog 231	4 000 000	3 403 020 lekë
<b>TOTALI</b>	<b>138 114 640 lekë</b>	<b>146 842 817 lekë</b>

Gjendje e karburantit me 31.12.2022 është:

Nafta 19 083 litra.  
Benzinë 5 636 litra.

#### **Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, realizimi i detyrave është bërë si më poshtë:

- Korrespondencë me MFE dhe Departamentin e Administratës Publike në lidhje me informacione të ndryshme për nëpunësit, vendet vakante për rekrutimin e punonjësve dhe emërimin e tyre.
- Raportime mujore në lidhje me largimet, emerimet, vendet vakante, proceset gjyqësore, dhe mbi informacione të ndryshme nga Ministria, apo DAP. Emerimi dhe lidhja e kontratave për punonjësit jashtë struktues sipas VKM-se, si dhe punonjësit e ekselencës.
- Hedhja e të dhënave të punonjësve të ri të emeruar nga DAP në HRMIS.
- Është kryer shpërndarja e karburantit, bazuar në kërkesat e Drejtorive
- Përgatitja e kohëshënuesve në fund të çdo muaji dhe përcjellja e tyre tek Sektorit të Financës.
- Janë përgatitur Urdhrat e lejeve të zakonshme për të gjithë punonjësit e DPM-së.
- Është mirmbajtur rrjeti kompjuterik duke bërë funksionimin normal të punës. Janë riparuar paisjet kompjuterike, (fotokopje printera, kompjutera). Është bërë e mundur përfaqsimi i DPM-së në komisionet e Ministrive për problem të ndryshme. Është bërë asistencë e punonjësve për probleme të ndryshme kompjuterike.
- Jane hartuar dhe jane miratuar në MFE pershkrimet e punës për çdo specialist të DPM-se.
- Është bërë inventari i të gjithë dosjeve të personelit duke zëvendësuar dokumentacionin që mungonte në keto dosje si dhe regjistrimi i tyre në programin HRMIS.
- Pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga Shkolla e Administratës Publike në lidhje
- Trajnim nga P.DKPKI mbi njohjen me sistemin elektronik të deklarimit të pasurisë si autoriteti përgjegjës.
- Krijimi i grupit të monitorimit dhe komunikimit me komisionerin mbikontrollin e personelit në periudhën e zgjedhjeve lokale.



- Eshte pergatitur dokumentacioni per punonjes te cilet mbaruan periudhen e provces dhe marrin statusin e nepunesit civil.
- Jane pergatitur vlersimet 6-mujore per nepunesit e tjere te DPM-se.
- Eshte bere raporti vjetor per ILDKPI-si dhe dokumentat bashkelidhur per deklarimin e pasurise si dhe per rastet e sinjalizimit sipas akteve Ilgjore ne fuqi.

### **Specialist Transportit**

Gjate periudhes janar-dhjetor 2022, ka realizuar detyrat si me poshte:

- Jane kryer sherbimet sipas kerkesave nga drejtorite e DPM.
- Eshte shperndare karburanti (nafte+benzine).
- Eshte plotesuar dokumentacioni perkates.
- Eshte kryer rakordimi me zyren e finances dhe magazine.
- Per muajt Mars-Dhjetor kemi zbatuar Vendimin nr. 160, date 14.03.2022 mbi reduktimin e shpenzimeve te Transportit.
- Per muajt ne vijim synohet realizimi i sherbimeve te ndryshme nga drejtorite e DPM-se duke zbatuar Vendimin nr. 160, date 14.03.2022.
- Eshte perfunduar procesi i riparim sherbimeve per nje pjese te mjeteve te drejtorise ne zbatim te kontrates se lidhur me subjektin "Alstezo" i cili eshte fitues i tenderit per riparim sherbime per mjetet e DPM-se.
- Eshte terhequr karburanti (18750 litra naftc) per vitin 2023 nga subjekti "Kastrati" i cili eshte fitues i tenderit te prokuruar nga Ministria e Brendshme.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

